



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET

"HAXHI ZEKA"

Lenda : Kontabiliteti Financiar
Departamenti : Kontabilitet dhe Financa

Msc. Valdrin Misiri

Pejë, Mars 2018

Kontabiliteti Financiar

- Viti II-të, Semestri IV
- Departamenti : KF
- Statusi i lëndes : Obligative
- Javët mësimore: 15 [4 orë ligjerata, 8 orë ushtrime(4 grupe)]
- Mësimdhënëse: Prof.Ass.Dr Fitim Deari
- Asistent: MSc.Valdrin Misiri
- Orari i ushtrimeve: E hene (G4 – ora 09:45 - 11:15 E4)
- (G3 – ora 13:15 - 14:45 CI)
- (G2 – ora 15:00 - 16:30 CI)
- Orari i ushtrimeve: E marte (G1 – ora 11:30 - 13:00 CI)
- E-mail: valdrin.misiri@unhz.eu
- Website: www.unhz.weebly.com

Hyrje

- Kontabiliteti është i rëndësishem në jetën tuaj personale, sidomos në qoftë se ju jeni menaxher apo pronar i një biznesi.
- Shumë njerëz, në jetën e përditshme, kontabilitetin e kuptojnë si një llogarimbajtje.
- Llogarimbajtja (book keeping) në fakt është një pjesë e procesit të kontabilitetit që ka të bëjë vetëm me regjistrimin e transaksioneve në librat e kontabilitetit.
- Ndryshe nga kjo, kontabiliteti është proces i identifikimit, regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të informacionit ekonomik për marrjen e vendimeve.

Organizimet e bizneseve dhe llojet e tyre


- Ne cdo shtet ekzistojnë organizime të ndryshme shoqerore.
- Varesisht nga lloji i veprimtarise operuese (afariste) te tyre ato klasifikohen ne tri grupe kryesore:
 1. Bizneset prodhuese
 2. Bizneset tregtare
 3. Bizneset sherbyese
- Bizneset prodhuese inputet e tyre i transferojne ne produkte te gatshme, te cilat pastaj u shesin bleresve te ndryshem.
- Bizneset tregtare kryesisht e blejne mallin prej bizneseve prodhuese , te cilin pastaj u shesin konsumatoreve final.
- Bizneset sherbyese aktivitetin primar e kane ofrimin e shitjes se sherbimeve klienteve te ndryshem.

Organizimet formale te biznesit

- Llojet kryesore jane:
 1. Bizneset Individuale
 2. Bizneset partnere (ortakerite)
 3. Korporatat (shoqerite aksionare)
- Bizneset individuale – jane ne pronesi te nje individi. Pronari i biznesit mund te jete menaxher dhe punetor i biznesit.
- Partneritetet – jane ne pronesi te dy ose me shume pronareve. Shume karakteristika te ngjajshme me bizneset individuale.
- Korporatat – jane entitete legale te krijuara mbi bazen e ligjeve te vecanta te shoqerive aksionare. Pronesia ne korporate krijohet mbi bazen e shperndarjes dhe transferimit te aksioneve te rregullta te cilat shiten ne tregjet e kapitaleve.

Kontabiliteti

- Pra, kontabiliteti është proces i identifikimit, regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të informacionit ekonomik për marrjen e vendimeve.
- Qellimi kryesor i kontabilitetit është që të sigurojë informata sa më cilësore që do të krijonin bazën për marrjen e vendimeve
- Dy degët kryesore të kontabilitetit janë:
 - ✓ Kontabiliteti financiar
 - ✓ Kontabiliteti i menaxhmentit



Kontabiliteti financiar dhe menaxhmentit

- Kontabiliteti financiar është fushë e kontabilitetit, qëllimi themelor i të cilit është përgatitja e pasqyrave financiare mbi bazën e rregullave të caktuara, sic është GAAP.
- Ku vlerësimi i pozites financiare më së miri operacionalizohet më së miri duke i përdorur analizat e pasqyrave financiare.
- Kontabiliteti i menaxhmentit është proces i përgatitjes, raportimit dhe interpretimit të informacionit llogaritar që u jepet marrësve të brendshëm të informatave.
- Pra kontabiliteti i menaxhmentit përdoret nga ana e menaxherëve për marrjen e vendimeve lidhur me: planifikimin operativ, kontrollin dhe menaxhimin e kostos

Perdoruesit e informatave te kontabilitetit financiar

- Informatat e kontabilitetit financiar prezentojne poziten financiare , perkatesisht per pasurine, detyrimet dhe kapitalin e vet si dhe rezultatet e aktivitetit afarist per nje periudhe te caktuar.
- Perdoruesi kryesor intern eshte menaxhmenti i ndermarrjes, ne te gjitha nivelet, dhe ne kete rast me se shumti nevojitet menaxhmenti financiar.
- Nga grupet ekstrne, informatat e kontabilitetit, ne radhe te pare, u dedikohen aksionereve dhe investitoreve potencial, pastaj kreditoreve, organeve shteterore dhe agjencioneve qeveritare, autoritetet fiskale, shoqata konsalting, asosacionet industriale dhe personeli i nder.

Organizatat profesionale nderkombetare te kontabilitetit

- Komiteti per Standarde Nderkombetare te Kontabilitetit (IASB)
- Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit (IASB)
- Ne strukturen e re te funksionimit te IASB-se brenda fondacionit te IASC-se funksionojne :
 1. Keshilli i Mbikeqyrjes se Standardeve (SAC) – mbikqyr punen e IASB-se dhe IASCF
 2. Komiteti i Interpretimit per Raportim Financiar Nderkombetar (IFRIC) – zhvillon interpretimet e aplikimit te SNRF-ve
 3. Grupet punuese – merren me projekte te medha te kontabilitetit

Organizatat e kontabilitetit ne SHBA

- Ne SHBA ekzistojne disa organizata dhe trupa profesionale te kontabilitetit, te cilat ndikojne ne zhvillimin e teorise dhe praktikes se kontabilitetit. Nder me te njohurat jane:
 1. Komisioni i letrave me vlere (SEC)
 2. Bordi i standardeve te kontabilitetit financiar (FASB)
 3. Instituti amerikan per kontabiliste publik te certifikuar (AICPA) dhe,
 4. Asocacioni i kontabilisteve amerikane (AAA)

Zhvillimet e kontabilitetit ne Kosove

- Ndertimi i sistemit te kontabilitetit, mbi bazat e SNK-se nuk mund ti shmanget as Kosova si pjese e Evropes dhe kembimit nderkombetar.
- Autoritet Qendror i Kosoves, per nxjerrjen e SKK-se eshte Bordi i Raportimit Financiar. Deri me tani, nga ky bord, jane nxjerre 18 standarde kosovare te kontabilitetit (SKK) te cilat jane ne harmoni me SNK-ne
- Ne listen aktuale te SNK-ve ekzistojne 33 standarde. Ne vitin 2003 eshte publikuar SNRF/IFRS, te gjitha standardet e reja tashme emrohen si SNRF/IFRS dhe lista aktuale e tyre ka arritur ne 16.

Pyetje



Suksese!